



Duke u mbështetur në nenin 17 nën i) dhe nenin 40 paragrafi 40.2 nën I) të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 40 paragrafi 40.2 nën pikën 11) të Statutit të Komunës së Klinës, me rekomandimet e komitetit për Politikë dhe Financa të dt.13.06.2016, me kërkesën e Grupit të grave Asambleiste të dt.16.05.2016, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të rregullt për vitin 2016, të mbajtur më dt.24.06.2016, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet, kërkesa e grupit të Grave Asambleiste për realizimin e Projektit për Promovimin e Ligjit për Barazi Gjinore -ngritjen e vetëdijesimit të grave të zonave rurale dhe urbane dhe ofrimin e mundësive për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut dhe n'uljen e diskriminimit gjinor.
- II. Vendimi si në pikën 1 kërkon mbështetje financiare në shumë prej 1,230€.
- III. Kompetent për ekzekutimin e këtij vendimi është Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe grupi i Grave asambleiste dhe Zyra për Barazi Gjinore.
- IV. Vendimi është i plotfuqishëm më miratimin në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL dhe konfirmimit të ligjshmërisë.

Me këtë vendim të njoftohen:

- MAPL,
- Kryetari i Komunës,
- Kryesuesi i Kuvendit,
- Drejtoria e FEZH
- Parashtruesit e kërkesës
- Zyra për informim
- Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe
- Arkivi i Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-3098 2016
Klinë, më 30.06 .2016



KRYESUESI,
Dr. Haxhi Ibishi